

Shporta Studentore e studentëve të fakultetit **Ekonomik, Filologjik** dhe **Shkencave Mjekësore**

Hulumtim



BOTUES:

Forumi për Ndryshime në Arsim Rr.Illindenska numër.87/13,
Tetovë, Maqedonia e Veriut.
Fech.mk@gmail.com
Ardit.ramadanni@gmail.com

AUTOR&REDAKTOR:

Ardit Ramadani

ANKETUES:

Sabrije Tefki, Kristijan Stefanovski, Ivan Trajkovski

PËRKTHYESE:

Behare Kasami

DIZAJN:

Vigan Demiri

VITI I BOTIMIT:

2024

Përmbajtja

Hyrje.....	07
Konteksti	08
Metodologjia	09
Fakulteti Ekonomik, Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”	10
Fakulteti Ekonomik, Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”	19
Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës.....	28
Anketë: Përceptimi i qytetarëve: Studentët dhe çmimet, lirë apo shtrenjtë?.....	37
Rekomandime.....	43

HYRJE

Forumit për Ndryshime në Arsim është themeluar në tetor të vitit 2021. Përgjatë dy viteve funksionim ka luajtur rol të rëndësishëm në identifikimin dhe adresimin e problematikave me të cilat përballen studentët dhe të rinjtë në përgjithësi në Maqedoninë e Veriut. Për Forumin për Ndryshime në Arsim është shumë e rëndësishme që fillimisht të ngritet vetëdija e studentëve në lidhje me atë se çfarë (nuk) ju takon dhe të nxitet mendimi i tyre kritik, më pas edhe vetëdija e përgjithshme e qytetarëve në Maqedoninë e Veriut në lidhje me këto problematika.

Përpos hulumtimeve më të thelluara dhe më të thukta që kemi publikuar deri tani, në faqjet zyrtare të Forumit për Ndryshime në Arsim www.fech.mk dhe www.studentsforum.mk publikojmë vazhdimisht analiza dhe studime të ndryshme në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me të rinjtë dhe cilësinë e arsimit në vend, me theks të veçantë arsimit të lartë. Ne jemi shumë të interesuar që të nxisim debat të shëndetshëm në lidhje me këto tema që i trajtojmë në mënyrë të vazhdueshme, kjo pasi ne konsiderojmë se studentët dhe të drejtat e tyre e meritojnë të jenë në fokusin e medieve dhe shoqërisë në përgjithësi më shumë dhe më shpesh se sa që janë aktualisht.

Në këtë kontekst, si Forum për Ndryshime në Arsim shprehim mirënjohjen tonë ndaj European Endowment for Democracy (EED) për mbështetjen dhe përkrahjen që i kanë dhënë misionit tonë për arsim të lartë më cilësor, më shumë të drejta studentore dhe pozitive më të mirë të të rinjve në shoqëri. Përmes kontributit të European Endowment for Democracy (EED), ne kemi arritur që të hedhim dritë mbi shumë çështje të rëndësishme që i tangojnë të rinjtë dhe studentët në Maqedoninë e Veriut.

Konteksti

Në sistemin universitar të Maqedonisë së Veriut janë pjesë gjithsej **53,821 studentë**, prej të cilëve **47,718** apo **77.7%** janë pjesë e universiteteve publike ndërsa **12,103** apo **22.3%** janë pjesë e institucioneve private të arsimit të lartë, sipas Entit Shtetëror për Statistika të Maqedonisë së Veriut.

Për ilustrim, Shporta Sindikale tregon që jetesa në Maqedoninë e Veriut çdo muaj vijon të bëhet më e kushtueshme, edhe atë: Në qoftë se dy të punësuar në një familje katër anëtarëshe kanë paga mesatare prej **38.359 denarëve**, ata duhet që me **74%** të parave t'i mbulojnë vetëm harxhimet minimale, përkatësisht duhet të i ndajnë $\frac{3}{4}$ nga të ardhurat në mënyrë që të arrijnë standardin themelor të të jetuarit.

Nuk ka dyshim që më të goditur nga kjo situatë janë studentët dhe të rinjtë, kjo pasi një pjesë e konsiderueshme prej tyre nuk janë të përfshirë në tregun e punës ndërsa ata që janë, kryesisht janë të angazhuar me orar të pjesshëm për shkak të angazhimeve me studimet dhe kanë të ardhura minimale prej **20.175 denarëve** (ose më pak) që sipas analizave të Lidhjes Sindikale të Maqedonisë së Veriut, është e pamundur që të kalohet muaji me aq para, sidomos duke marrë parasysh çmimet aktuale të produkteve bazë dhe aktiviteteve të nevojshme për studentët dhe të rinjtë në vend.

Sipas të dhënave të fundit nga Enti Shtetërorë për Statistika shkalla më e lartë e papunësisë është tek të rinjtë. Sipas strukturës së moshës, shkalla e papunësisë tek personat e moshës prej 15 deri në 29 vjeç është **24%** ndërsa gjithsej **102.134 persona** janë të regjistruar si të papunë në vend, prej të cilëve **41.3%** janë maqedonas ndërsa 38.4% janë shqiptarë. Duhet të theksohet se përkundër faktit që të dhënat e fundit janë inkurajuese dhe tregojnë trend të uljes së papunësisë së përgjithshme në krahasim me vitet paraprake, papunësia gjithsesi ngelet më e larta dhe thuhet se përdryshueshme tek të rinjtë e vendit.

Pjesa më e madhe e studentëve gjatës studimeve paguajnë për participim 200 euro për semestër, megjithatë kjo shumë mund të variojë sipas fakulteteve përkatëse, gjysmën e këtij çmimi e paguajnë studentët që janë me kuotë shtetërore. Sipas Ligjit për Arsim të Lartë, universitetet kanë të drejtë të propozojnë rritjen ose zvogëlimin e shumës për participim ndërsa shumën maksimale e përcakton Këshilli Kombëtar për Arsim të Lartë dhe Veprimtari Shkencor-Hulumtuese. Maqedonia e Veriut është e treta në rajon për nga lartësia e bursave që ndanë për studentët, edhe atë gjithëj **6.050 denarë** apo **98 euro**, me përjashtim të studentëve të kimisë, fizikës, matematikës, bujqësisë, veterinarisë dhe shkencave pyjore të cilët marrin bursa mujore prej **18.000 denarëve** apo **292 eurove**.

Metodologjia

Hulumtimi është i bazuar në të dhëna kualitative dhe kuantitative, të siguruar 100 për qind nga autori i këtij hulumtimi dhe anketuesve pjesëmarrës. Në pjesën e parë të hulumtimit kemi organizuar **3 fokus-grupe** ose **intervista një-me-një me studentë nga tre fakultete të ndryshme** të universiteteve të cilat funksionojnë në Maqedoninë e Veriut. Në këto tre fokus-grupe ose intervista një-me-një kanë marrë pjesë gjithsej **18 studentë** deridiplomik.

Forumi për Ndryshime në Arsim synon të krijojë **“Shportën Studentore”** me anë të së cilës do të shpërfaqet një fotografi e qartë e harxhimeve studentore, kjo pasi të kemi hulumtuar harxhimet e studentëve të të gjitha fakulteteve në vend. Në pjesën e parë të këtij publikimi në lidhje me atë se sa realisht ju kushton studentëve financiarisht procesi i studimit në vend dhe a janë ndihmat e shtetit për studentët në këtë drejtim të mjaftueshme, kemi intervistuar student të këtyre fakulteteve, edhe atë:

Fakulteti Ekonomik, Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”	6 studentë
Fakulteti Filologjik, Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”	6 studentë
Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës	6 studentë

Jemi siguruar që në mesin e studentëve të intervistuar të ketë edhe studentë të huaj që kanë zgjedhur të studiojnë në Maqedoninë e Veriut, kryesisht vijnë nga Republika e Kosovës. Një pjesë e të intervistuarve vendosën që të qëndrojnë anonim në këtë publikim për shkaqe të ndryshme personale ndërsa Forumi për Ndryshime në Arsim vendosi që të respektojë vendimin e tyre.

Studentët e intervistuar janë përgjigjur në gjithsej **24 pyetje**, prej të cilave gjashtë janë pyetje demografike, përkatësisht që kanë të bëjnë me prejardhjen e tyre, ky element është i rëndësishëm për procesin e analizimit më pas të secilës intervistë nga ana e autorit të hulumtimit. Në **8 pyetje** të intervistuarve ju është dhënë mundësia që të përgjigjen vetëm me shifra dhe janë pyetur kryesisht në lidhje me harxhimet e tyre studentore të përditshme, mujore dhe për një semestër. Në **10 pyetjet** e fundit ju kemi lënë hapësirë të intervistuarve që t'i shtjellojnë përgjigjet e dhëna vetëm me numra, kështu anketuesit tanë kanë zhvilluar bisedë me të intervistuarit në lidhje me mendimin e tyre për lartësinë e harxhimeve që i kanë si studentë.

Të intervistuarit janë pyetur në lidhje me atë se sa paguajnë për një semestër, sa harxhojnë për afërsisht për literaturë dhe materiale tjera shkollore të nevojshme për një semestër, sa harxhojnë për udhëtim, dhe me çka udhëtojnë deri në universitet, sa janë harxhimet e tyre ditore për ushqim gjatë kohës që janë në fakultet, sa harxhojnë për banim në qoftë se qëndrojnë në konvikt studentor ose banesë private si dhe sa para harxhojnë për rekreacion, përkatësisht për sport, kulturë dhe tjera.

Përkundër faktit që të gjithë të intervistuarve ua kemi parashtruar pyetjet e njëjta, të dhënat që i kemi marrë nga fakultetet e ndryshme nuk do t'i krahasojmë pasi harxhimet nga një fakultet në tjetrin variojnë dhe nuk janë të krahasueshme. Në pjesën e dytë të këtij hulumtimi do të prezantojmë të dhëna nga perceptimi i gjithsej **184 qytetarëve** të anketuar në lidhje me harxhimet e studentëve.

Fakulteti Ekonomik, Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”



Harxhimet për një semestër

Participimi me kuotë shtetërore	6.160 DENARË
Vetëfinancim	12.321 DENARË
Harxhimet administrative	1.400 DENARË
Tjera	750 DENARË

Studentët e Fakultetit Ekonomik paguajnë **12.321 denarë** për një semestër që nënkupton **24.642 denarë në vit**. Studentët të cilët kanë treguar rezultate të mira në shkollë të mesme, përkatësisht **30 studentët** e ranguar më mirë në këtë drejtim paguajnë në gjysmë çmimi, përkatësisht **6.160 denarë** për semestër dhe **12.321 denarë në vit**.

Në harxhimet administrative bëjnë pjesë fondi i librave, shfrytëzimi i shërbimeve përmes internetit dhe e-platformave, dëmtimet, fletore, kodet për provimet me shkrim dhe qendrën studentore për internet. Në harxhimet nën kategorinë 'tjera' bëjnë pjesë veprimtaritë informative, sportive, kulturore të studentëve. kjo pagesë realizohet 1 herë në vit, edhe atë gjatë regjistrimit të semestrit dimëror.

Studentët gjithashtu mund të aplikojnë për kategori të ndryshme të bursave, shuma e bursës që ju takon studentëve është **6.050 denarë**, me përjashtim të disa fakulteteve që i kanë bursat më të larta për shkak të numrit të vogël të studentëve.

Të liruar nga participimi gjithashtu janë personat më të rinj se mosha 26 vjeçe dhe që nuk kanë prind dhe janë të papunë, personat me invaliditet, invalidë ushtarak si dhe personat e rritur në shtëpi për fëmijë të braktisur nëse janë të papunë.



Shpenzimet për literaturë

Studentët kanë raportuar se shpenzojnë mesatarisht **3.520 denarë** për semester në literaturë të nevojshme për studime. Shuma më e lartë e raportuar nga të anketuarit e këtij fakulteti është **6.120 denarë** ndërsa shuma më e vogël **1.000 denarë**. Studentët ishin me mendime të ndara në lidhje me këtë shumë, një pjesë e të anketuarve konsideronin se është i lartë dhe i papërballueshëm për ata kurse tjerët thanë se çmimi është i arsyeshëm.

Të gjithë të anketuarit pa përjashtim kanë deklaruar se literatura është lehtësisht e qasshme, qoftë privatisht apo në bibliotekën e fakultetit. Disa prej studentëve kanë raportuar se të paktën një herë përgjatë studimeve janë ndjerë të detyruar nga ana e profesorëve të disa lëndëve të veçanta për të blerë librat e tyre, rrjedhimisht, ata janë përballë me shitje të kopjeve jo të autorizuara nga autorët e librave.

Shpenzimet për materiale shpenzuese

Studentët kanë raportuar se shpenzojnë mesatarisht **1.400 denarë** në semestër për materiale tjera shkollore të nevojshme për studime. Këto materiale përfshijnë: çanta, stilografa, hamera dhe tjera. Studentët kanë deklaruar se harxhimet për materiale shpenzuese nuk janë të larta pasi pjesën më të madhe të tyre e blejnë vetëm një herë dhe e përdorin gjatë gjithë vitit, përkatësisht për më shumë se një semestër.

Por përkundër shumës jo të lartë për materiale shpenzuese, studentët raportuan se nuk do të kishin mundësi t'i blejnë këto materiale të nevojshme për studime në qoftë se nuk do të kishin ndihmë financiare nga ana e prindërve, të gjithë studentët e anketuar pa përjashtim kanë deklaruar se të gjitha harxhimet ua mbulojnë prindërit.



Shpenzimi mesatar për 1 semestër

1400 MKD

Shpenzimet e udhëtimit

Studentët kanë raportuar se harxhojnë mesatarisht **9.340 denarë** në semestër për transport nga shtëpia e tyre deri te fakulteti ekonomik ose vendi ku i mbajnë ligjëratat. Këtu duhet theksuar se është marrë vetëm mesatarja e studentëve të cilët udhëtojnë nga qytete tjera në Shkup për ligjëratat ose studentëve të cilët për arsye të ndryshme nuk e shfrytëzojnë të drejtën për transport publik falas.

Për këta studentë të cilët udhëtojnë nga qytete të ndryshme për në universitet ofrohet një bursë nga **600** deri në **1.200 denarë**, shumë kjo që nuk është e mjaftueshme. Megjithatë, kjo bursë është e përkohshme dhe bën pjesë në masat antikrizë të ndërmarra nga qeveria e Maqedonisë së Veriut.

Të gjithë studentët e universiteteve publike në Maqedoninë e Veriut janë të liruar nga pagesa e transportit publik në Shkup, por pjesa më e madhe e studentëve në universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” udhëtojnë nga qytete tjera dhe jo të gjithë jetojnë në Shkup, përkatësisht në semestrin veror 2022/3 janë regjistruar **11.452 studentë** prej Shkupi **11.812 studentë** nga qytete tjera, por edhe për ata ka lehtësime të biletave mujore.



26400 MKD

Shpenzimi mesatar për 1 semestër



Shpenzimet e banimit

Studentët kanë raportuar se shpenzojnë mesatarisht **26.400 denarë** në semester për banim. Këtu është llogaritur vetëm mesatarja e studentëve të cilët jetojnë në banesa private apo konvikte studentore, pasi një pjesë e të anketuarve janë shprehur se nuk kanë harxhime në këtë pjesë pasi banojnë në objekte familjare.

Në Maqedoninë e Veriut ka gjithsej **10 konvikte** shtetërore për studentët, çmimi mujor për akomodim në këto konvikte studentore është **3.410 denarë**. Studentët të cilët banojnë në konvikte studentore raportuan se përballen me kushte të këqija infrastrukturore por jo vetëm, thanë se ushqimi që ju servohet nuk është i mire ndërsa as higjiena nuk është në nivel. Një pjesë e tyre thanë se përkundër çmimit më të lartë, kushtet e këqija në konviktet studentore i kanë detyruar të marrin banesa private me qera. Në këtë mesatarë përfshihet edhe pagesa për rrymën, ujin dhe internetin.

Shpenzimet për ushqim

Studentët kanë raportuar se harxhojnë mesatarisht **12.650 denarë** në semestër për ushqim. Këtu duhet të merret parasysh se një pjesë e studentëve banojnë në konviktet studentore ku edhe ushqimin e kanë të siguar, përveç kësaj, të gjithë studentët marrin nga **140 denarë** në ditë, 6 herë në javë për një vakt të shëndetshëm ushqimor.

Të gjithë të anketuarit pa përjashtim kanë raportuar se çmimi i ushqimit në bufenë e universitetit është tejet i lartë dhe se nuk ka asnjë lloj zbritje ose lehtësimi për ata, përpos kësaj, ata kanë denoncuar se kualiteti i ushqimit nuk është i mirë ndërsa nuk ka zgjedhje të mjaftueshme të ushqimit që ofrohet. Ata gjithashtu konsiderojnë se shumica prej **140 denarësh** në ditë për shujtë studentore është e ulët duke marrë parasysh çmimet e larta në treg, thonë se me këto para nuk mund të blejnë ushqim të mjaftueshëm për një vakt ushqimor.





Shpenzimet për rekreacion

Studentët kanë raportuar se harxhojnë mesatarisht **14.202 denarë** për rekreacion. Si shpenzime më të shpeshta në këtë kategori janë kafe, shëtitje, aktivitete sportive, cigare, evente rinore, koncerte dhe ngjashëm. Kuvendi Studentor Universitar shpesh herë organizon ngjarje rekreative për studentët, por jo gjithmonë këto ngjarje janë pa pagesë ose me lehtësime për studentët e universitetit përkatës, përpos kësaj, ky kuvend studentor ka lidhur bashkëpunim me disa palestra që ju mundëson studentëve çmime më të lira mujore në qendrat përkatëse.

Të gjithë të intervistuarit janë shprehur se janë të detyruar që t'i kufizojnë shëtitjet ose të heqin dorë nga një pjesë e madhe e aktiviteteve për shkak të çmimeve të larta, thonë se ia dalin të paguajnë vetëm për gjërat e domosdoshme. Një pjesë e tyre thanë se shkojnë regullisht në fitness, por u ankuan për çmimet e larta në palestrat, thanë se duhet të jenë më lira për studentët.

HARXHIMI MESTAR PËR NJË SEMESTËR

81,335 DENARË

(1,317 EURO)

PËR NJË VIT AKADEMIK

162,670 DENARË

(2,634 EURO)

DERI NË KRYERJE TË STUDIMEVE
DERIDIPLOMIKE

650,680 DENARË

(10,535 EURO)

**Fakulteti Filologjik,
Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”**



Harxhimet për një semestër

Participimi me kuotë shtetërore	6.160 DENARË
Vetëfinancim	12.321 DENARË
Harxhimet administrative	500 DENARË
Tjera	750 DENARË

Studentët e Fakultetit Ekonomik paguajnë **12.321 denarë** për një semestër që nënkupton **24.642 denarë në vit**. Studentët të cilët kanë treguar rezultate të mira në shkollë të mesme, përkatësisht 30 studentët e ranguar më mirë në këtë drejtim paguajnë në gjysmë çmimi, përkatësisht **6.160 denarë** për semestër dhe **12.321 denarë në vit**.

Në harxhimet administrative bëjnë pjesë fondi librave, shfrytëzimi i shërbimeve përmes internetit dhe e-platformave, dëmtimet, fletore, kodet për provimet me shkrim dhe qendrën studentore për internet. Në harxhimet nën kategorinë 'tjera' bëjnë pjesë veprimtaritë informative, sportive, kulturore të studentëve. Kjo pagesë realizohet 1 herë në vit, edhe atë gjatë regjistrimit të semestrit dimëror.

Studentët gjithashtu mund të aplikojnë për kategori të ndryshme të bursave, shuma e bursës që ju takon studentëve është **6.050 denarë**, me përjashtim të disa fakulteteve që i kanë bursat më të larta për shkak të numrit të vogël të studentëve.

Të liruar nga participimi gjithashtu janë personat më të rinj se mosha **26 vjeçe** dhe që nuk kanë prind dhe janë të papunë, personat me invaliditet, invalidë ushtarak si dhe personat e rritur në shtëpi për fëmijë të braktisur nëse janë të papunë.



Shpenzimet për Literaturë


Studentët kanë raportuar se shpenzojnë mesatarisht **2.012 denarë** për semester në literaturë të nevojshme për studime. Shuma më e lartë e raportuar nga të anketuarit e këtij fakulteti është **3.060 denarë** ndërsa shuma më e vogël **1.000 denarë**. Studentët thonë se çmimet për literaturë janë relativisht të shtrenjta, pasi ndonjë semestër të gjitha librat e nevojshëm kanë qenë të shtrenjta por ju ndihmon fakti që një pjesë të librave mund t'i shkarkojnë nga interneti.

Vetëm një prej të intervistuarve në këtë fakultet ka raportuar se një profesor ia ka ulur notën përfundimtare pasi nuk e ka shfrytëzuar librin e tij gjatë semestri, tjerët thonë se në asnjë moment nuk janë ndjerë të detyruar që t'i blejnë librat e profesorëve apo nga ana e profesorëve.

Shpenzimet për materiale shpenzuese

Studentët kanë raportuar se shpenzojnë mesatarisht **760 denarë** në semestër për materiale tjera shkollore të nevojshme për studime. Këto materiale përfshijnë: çanta, stilografa, hamera dhe tjera. Studentët thonë se çmimet për materiale shpenzuese kanë pësuar rritje kohës së fundit, por gjithsesi konsiderojnë se janë të përballueshme.

Të gjithë të intervistuarit në këtë fakultet thanë se çdo harxhim ju mbulohet nga ana e prindërve dhe se ndryshe nuk do të mund t'i përballonin harxhimet përgjatë një semestri, pasi pjesa më e madhe e tyre janë të papunë dhe të fokusuar tërësisht në shkollim.




Shpenzimet e udhëtimit

Studentët kanë raportuar se harxhojnë mesatarisht **10.340 denarë** në semestër për transport nga shtëpia e tyre deri te fakulteti filologjik ose vendi ku i mbajnë ligjëratat. Këtu duhet theksuar se është marrë vetëm mesatarja e studentëve të cilët udhëtojnë nga qytete tjera në Shkup për ligjëra-ta ose studentëve të cilët për x arsye nuk e shfrytëzojnë të drejtën për transport publik falas.

Për këta studentë të cilët udhëtojnë nga qytete të ndryshme për në universitet ofrohet një bursë nga **600** deri në **1.200 denarë**, shumë kjo që nuk është e mjaftueshme. Megjithatë, kjo bursë është e përkohshme dhe bën pjesë në masat antikrizë të ndërmarra nga qeveria e Maqedonisë së Veriut.

Të gjithë studentët e universiteteve publike në Maqedoninë e Veriut janë të liruar nga pagesa e transportit publik në Shkup, por pjesa më e madhe e studentëve në universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” udhëtojnë nga qytete tjera dhe jo të gjithë jetojnë në Shkup, përkatësisht në semestrin veror 2022/3 janë regjistruar **11.1452 studentë prej Shkupi 11.812 studentë nga qytete tjera**, por edhe për ata ka lehtësime të biletave mujore.



Shpenzimet e banimit

Studentët kanë raportuar se shpenzojnë mesatarisht **21.875 denarë** në semester për banim. Këtu është llogaritur vetëm mesatarja e studentëve të cilët jetojnë në banesa private apo konvikte studentore, pasi një pjesë e të anketuarve janë shprehur se nuk kanë harxhime në këtë pjesë pasi banojnë në objekte familjare.

Në Maqedoninë e Veriut ka gjithsej 10 konvikte shtetërore për studentët, çmimi mujor për akomodim në këto konvikte studentore është **3.410 denarë**. Studentët të cilët banojnë në konvikte studentore raportuan se përballen me kushte të këqija infrastrukturore por jo vetëm, thanë se ushqimi që ju servohet nuk është i mirë ndërsa as higjiena nuk është në nivel. Një pjesë e tyre thanë se përkundër çmimit më të lartë, kushtet e këqija në konviktet studentore i kanë detyruar të marrin banesa private me qera. Në këtë mesatarë përfshihet edhe pagesa për rrymën, ujin dhe internetin.






Shpenzimet për ushqim

Studentët kanë raportuar se harxhojnë mesatarisht **12.958 denarë** në semestër për ushqim. Këtu duhet të merret parasysh se një pjesë e studentëve banojnë në konviktet studentore ku edhe ushqimin e kanë të siguar, përveç kësaj, të gjithë studentët marrin nga **140 denarë** në ditë, 6 herë në javë për një vakt të shëndetshëm ushqimor.

Të gjithë studentët e intervistuar thonë se nuk konsumojnë ushqimin e bufesë universitare pasi që konsiderojnë se çmimet janë tejet të larta, kualiteti i ushqimit nuk është i mirë dhe mungon higjiena. Të gjithë studentët e intervistuar marrin nga **140 denarë** në ditë për një vakt ushqimor, por thonë se kjo shifër nuk është e mjaftueshme pasi çmimet në treg janë shumë të larta.



Shpenzimet për rekreacion

Studentët kanë raportuar se harxhojnë mesatarisht **11.758 denarë** për rekreacion. Si shpenzime më të shpeshta në këtë kategori janë kafe, shëtitje, aktivitete sportive, cigare, evente rinore, koncerte dhe ngjashëm. Kuvendi Studentor Universitar shpesh herë organizon ngjarje rekreative për studentët, por jo gjithmonë këto ngjarje janë pa pagesë ose me lehtësime për studentët e universitetit përkatës, përpos kësaj, ky kuvend studentor ka lidhur bashkëpunim me disa palestra që ju mundëson studentëve çmime më të lira mujore në qendrat përkatëse.

Të gjithë të intervistuarit janë shprehur se nuk mundën që plotësisht t'ia plotësojnë vetes dëshirat që i kanë për aktivitete rekreative, kjo pasi pjesa më e madhe e tyre janë të papunë dhe harxhimet ua mbulojnë tërësisht prindërit. Një pjesë thanë se janë të regjistruar për ndonjë sport të caktuar, por thanë se s'kanë asnjë lirim ose lehtësim si studentë në këtë drejtim.

HARXHIMI MESTAR PËR NJË SEMESTËR

72,618 DENARË

(1,176 EURO)

PËR NJË VIT AKADEMIK

145,236 DENARË

(2,352 EURO)

DERI NË KRYERJE TË STUDIMEVE
DERIDIPLOMIKE

580,944 DENARË

(9,406 EURO)

Fakulteti i Shkencave Mjekesore
Universiteti “Universiteti i Tetovës”



Harxhimet për një semestër

Participimi me kuotë shtetërore	6.160 DENARË
Vetëfinancim	12.321 DENARË
Tjera	750 DENARË
Tarifa e shkollimit për shtetasit e huaj, Mjekësi e përgjithshme, Stomatologji dhe Famarci	61.602 DENARË
Tarifa e shkollimit për shtetasit e huaj, Fizioterapi, Mami dhe Infermieri	30.800 DENARË

Studentët e Fakultetit të Shkencave Mjekësore paguajnë **12.321 denarë** për një semestër që nënkupton **24.642 denarë në vit**. Studentët të cilët janë me kuotë shtetërore paguajnë gjysmën e kësaj shume për një semestër, përkatësisht **6.160 denarë për semestër** dhe **12.321 denarë në vit**.

Shuma prej **750 denarëve** përfshinë veprimtarinë informative, sportive dhe kulturore të studentëve. Kjo pagesë nga studentët e këtij fakulteti realizohet vetëm një herë gjatë gjithë studimeve, përkatësisht kur regjistrohen studentët. Studentët gjithashtu paguajnë nga **100 denarë** në vit për Kuvendin Studentor.

Studentët gjithashtu mund të aplikojnë për kategori të ndryshme të bursave, shuma e bursës që ju takon studentëve është **6.050 denarë**, me përjashtim të disa që i kanë bursat më të larta për shkak të numrit të vogël të studentëve.

Të liruar nga participimi gjithashtu janë personat më të rinj se mosha 26 vjeçe dhe që nuk kanë prind dhe janë të papunë, personat me invaliditet, invalidë ushtarak si dhe personat e rritur në shtëpi për fëmijë të braktisur nëse janë të papunë.



Harxhimet për një semestër

Studentët kanë raportuar se shpenzojnë mesatarisht **6.579 denarë** për semester në literature të nevojshme për studime. Shuma më e lartë e raportuar nga të anketuarit e këtij fakulteti është **9.258 denarë** ndërsa shuma më e vogël **4.320 denarë**. Të intervistuarit kanë deklaruar se çmimet për literaturë janë tejet të larta, por theksojnë se literatura e nevojshme për studime mund të gjendet lehtë.

Të gjithë këta të invertisuar kanë raportuar se përveç që profesorët i detyrojnë që në 'të zezë' t'i blejnë librat e tyre, pjesa më e madhe e profesorëve nuk i lejojnë studentët që të futen në provim në qoftë se nuk tregojnë dëshmi se studenti ka blerë librin e profesorit përkatës. Disa prej tyre thanë se një shtypshkronjë afër fakultetit mbanë shënim me emrat e studentëve që blejnë librat.

Harxhimet për një semestër

Studentët kanë raportuar se shpenzojnë mesatarisht **6.579 denarë** për semester në literaturë të nevojshme për studime. Shuma më e lartë e raportuar nga të anketuarit e këtij fakulteti është **9.258 denarë** ndërsa shuma më e vogël **4.320 denarë**. Të intervistuarit kanë deklaruar se çmimet për literaturë janë tejet të larta, por theksojnë se literatura e nevojshme për studime mund të gjendet lehtë.

Të gjithë këta të inversituar kanë raportuar se përveç që profesorët i detyrojnë që në 'të zezë' t'i blejnë librat e tyre, pjesa më e madhe e profesorëve nuk i lejojnë studentët që të futen në provim në qoftë se nuk tregojnë dëshmi se studenti ka blerë librin e profesorit përkatës. Disa prej tyre thanë se një shtypshkronjë afër fakultetit mbanë shënim me emrat e studentëve që blejnë librat.



Shpenzimi mesatar për 1 semestër


2476 MKD

Shpenzimet e udhëtimit

Studentët kanë raportuar se harxhojnë mesatarisht **6.541 denarë** në semestër për transport nga shtëpia e tyre deri te fakulteti i shkencave mjekësore ose vendi ku i mbajnë ligjëratat. Këtu duhet theksuar se është marrë vetëm mesatarja e studentëve të cilët udhëtojnë nga qytete tjera në Tetovë për ligjërata ose studentëve që shfrytëzojnë transportin publik për në fakultet.

Për këta studentë të cilët udhëtojnë nga qytete të ndryshme për në universitet ofrohet një bursë nga **600** deri në **1.200 denarë**, shumë kjo që nuk është e mjaftueshme. Megjithatë, kjo bursë është e përkohshme dhe bën pjesë në masat antikrizë të ndërmarra nga qeveria e Maqedonisë së Veriut.

Për dallim nga Shkupi, në Tetovë transporti publik nuk është falas për studentët ndërsa pjesa më e madhe e studentëve në këtë fakultet vijnë nga fshatrat përreth qytetit të Tetovës si dhe nga Kosova.



Shpenzimet e banimit

Studentët kanë raportuar se shpenzojnë mesatarisht **14.809 denarë** në semester për banim. Këtu është llogaritur vetëm mesatarja e studentëve të cilët jetojnë në banesa private apo konvikte studentore, pasi një pjesë e të anketuarve janë shprehur se nuk kanë harxhime në këtë pjesë pasi banojnë në objekte familjare.


Në Maqedoninë e Veriut ka gjithsej 10 konvikte shtetërore për studentët, çmimi mujor për akomodim në këto konvikte studentore është **3.410 denarë**. Studentët të cilët banojnë në konvikte studentore raportuan se përballen me kushte të këqija infrastrukturore por jo vetëm, thanë se ushqimi që ju servohet nuk është i mire ndërsa as higjiena nuk është në nivel. Por ky nuk është rasti në Tetovë, pasi konvikti studentor në këtë qytet është i ri dhe me kushte të mira për jetesë.



Shpenzimet për ushqim

Studentët e këtij fakulteti kanë raportuar se harxhojnë mesatarisht **15.689 denarë** në semestër për ushqim. Këtu duhet të merret parasysh se një pjesë e studentëve banojnë në konviktet studentore ku edhe ushqimin e kanë të siguar, përveç kësaj, të gjithë studentët marrin nga **140 denarë** në ditë, 6 herë në javë për një vakt të shëndetshëm ushqimor.

Studentët raportuan se nuk kanë bufe universitare ndërsa çmimet në lokalet përreth universitetit janë shumë të shtrenjta, pa asnjë lehtësim për ata si studentë. Të gjithë thanë se shfrytëzojnë 140 denarë në ditë për shujtë studentore, por konsiderojnë se kjo shumë është shumë e vogël dhe e pamjaftueshme, marrë parasysh çmimet e larta të produkteve ushqimore.





Shpenzimet për rekreacion

Studentët kanë raportuar se harxhojnë mesatarisht **11.360 denarë** për rekreacion. Si shpenzime më të shpeshta në këtë kategori janë kafe, shëtitje, aktivitete sportive, cigare, evente rinore, koncerte dhe ngjashëm. Kuvendi Studentor Universitar nuk është aktiv dhe nuk organizon aktivitete rekreative për studentët e këtij unviersiteti, pjesën më të madhe të aktiviteteve rekreative ata i organizojnë vetë, që është më e kushtueshme.

Të gjithë të intervistuarit në këtë fakultet kanë deklaruar se janë të detyruar që t'i limitojnë daljet për argëtim ose aktivitete tjera rekreative për shkak të harxhimeve të larta. Një pjesë e tyre thanë se janë të regjistruar në palestër por u ankuan për çmimet e larta, bënë thirrje që kuvendi studentor universitar të nënshkruaje marrëveshje me qendrat për fitness në qytet që studentëve të ju mundësohet zbritje.

HARXHIMI MESTAR PËR NJË SEMESTËR

69,850 DENARË

(1,131 EURO)

PËR NJË VIT AKADEMIK

139,700 DENARË

(2,262 EURO)

DERI NË KRYERJE TË STUDIMEVE
DERI DIPLOMIKE

698,500 DENARË

(11,309 EURO)

STUDENTËT DHE ÇMIMET, LIRË APO SHITRENJTË? PERCEPTIMI I QYTETARËVE



Në pjesën e dytë të hulumtimit **“Shporta e Studentëve të fakultetit Ekonomik, Filologjik dhe atë të Shkencave Mjekësore”** kemi anketuar **online (përmes internetit)** gjithsej **185 persona** për të mësuar perceptimin e përgjithshëm të qytetarëve në lidhje me çmimet në raport me studentët.

Pjesa më e madhe e personave që kanë plotësuar këtë anketë janë nga **Shkupi dhe Tetova**, kjo pasi në këto dy qytete ndodhen pjesa më e madhe e universiteteve në vend dhe kontakti i njerëzve me studentët është më i shpeshtë. Qëllimi i pyetësorit ishte që të marrim mendimin e përgjithshëm në lidhje me këtë temë, përpos atë të studentëve të cilit ja kemi kushtuar krejtësisht pjesën e parë të hulumtimit.


Anketën e kanë plotësuar gjithsej **185 persona, 30,8% nga Shkupi, 29.2% nga Tetova, 8.6% nga Gostivari, 7% nga Kërçova** dhe pjesa tjetër nga qytete tjera të Maqedonisë së Veriut. **56.2%** e të anketuarve janë burra ndërsa **43.8%** gra. Pjesa më e madhe e të anketuarve, përkatësisht **47%** janë studentë, **29.2%** persona të punësuar ndërsa **23.8%** të papunë.

Kjo anketë përmes internetit ka pasur gjithsej **15 pyetje**, prej të cilave **4** kanë qenë demografike ndërsa **11** të përgjithshme. Pyetjet në këtë anketë kanë qenë kryesisht në lidhje me atë se sa të (pa) përballueshme konsiderojnë të anketuarit se janë çmimet nga produktet bazë deri te ata më luksoze për studentët dhe se cili është roli i shtetit në këtë drejtim, sa ju ndihmon studentëve përmes politikave të ndryshme.


Përpos organeve shtetërore, jemi interesuar në lidhje me mendimin e tyre për atë se sa universitetet në vendin tonë kanë politika financiare ndihmuese për studentët dhe se a janë të mjaftueshme bursat studentore. Kemi marrë mendimin e përgjithshëm në lidhje me shumën prej **140 denarëve** për shujtë studentore që e marrin studentët, në lidhje me shumën e pagesës së konviktit studentor, semestrit, materialeve shkollore, si dhe në lidhje me atë se a kanë studentët mundësi financiare për aktivitete kulturore, sportive dhe turistike.

Në këtë pjesë të hulumtimit **“Shporta e Studentëve të fakultetit Ekonomik, Filologjik dhe të Shkencave Mjekësore”** do të shfaqen **11** gjetjet më të rëndësishme anketës që është realizuar përmes instrumenteve online


A mendoni se çmimet e produkteve ushqimore bazë janë të shtrenjta?




A mendoni se çmimet e produkteve ushqimore bazë janë të përballueshme për studentët në Maqedoninë e Veriut?




A mendoni se ndihmat e institucioneve shtetërore për studentët janë të mjaftueshme në këtë drejtim?




A mendoni se universitetet përkatëse ofrojnë mjaftueshëm ndihma/bursa për studentët?




A mendoni se 140 denarë në ditë është shumë e mjaftueshme për studentët, si ndihmë që ndahet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës?




A mendoni se çmimi prej 3,410 denarëve në muaj për konviktin studentor është i arsyeshëm dhe i përbalueshëm për studentët?




A mendoni se çmimi i studimeve/semestrit në universitetet publike është i lartë?




A mendoni se çmimet e librave dhe materialeve tjera për mësim janë të larta dhe të papërballeshme për studentët?




A mendoni se studentët kanë mundësi financiare për aktivitete kulturore, sportive dhe turistike?



A mendoni se studentët mund t'i përballojnë harxhimet mujore duke mos qenë të punësuar?



Si e shihni situatën ekonomike dhe standardin e jetesës së studentëve në 12 muajt e ardhshëm?



Rekomandime

Arsimi i lartë publik të jetë falas për të gjithë studentët

Të digjitalizohen shërbimet administrative në mënyrë që studentët të mos detyrohen të paguajnë shtesë për dokumente në sportele

Të rritet shuma e bursave shtetërore dhe të zgjerohet lista e fakulteteve me bursat më të larta

Të zgjerohet lista e kategorive të studentëve përfitues të bursave shtetërore

Të zgjerohet lista e kategorive të studentëve që lirohen nga participimi

Të themelohet trup hetues brenda universiteteve për profesorët që detyrojnë studentët t'i blejnë librat e tyre

Të lirohen nga pagesa për transport publik në Shkup të gjithë studentët, pa marrë parasysh universitetit që studiojnë

Të lirohen nga pagesa për transport publik studentët në të gjitha qytetet universitare

Të krijohet sistem i qëndrueshëm për lehtësimin e transportit ndërkomunal të studentëve

Të përmirësohen kushtet në konviktet studentore në mënyrë që studentët të mos detyrohen të paguajnë banesa private

Të ketë trup mbikëqyrës të organit selektues të studentëve që pranohen në konvikte, ka denoncime për selektim joadekuat dhe diskriminues

Studentët të kenë qasje falas në të gjitha materialet e domosdoshme mësimore

Të rritet shuma e shujtës studentore bazë të rritjes së inflacionit të shportës konsumatore në fundvit

Të ulen çmimet e ushqimeve në byfenë e universiteteve

Të ofrohen më shumë ndihma shtetërore për aktivitete turistike për studentët, për brenda dhe jashtë shtetit

Palestrat dhe pishinat publike të jenë falas për studentët



EUROPEAN
ENDOWMENT FOR DEMOCRACY